



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësua
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.61/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësua (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Nenad Lazić dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me zyrtaren ligjore Robertina Lekaj, duke vendosur përkritazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterve në hapësira publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 06.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, dhe koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Shtime, i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 2,500.00 (dymijepesëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 05.06.2017, nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me të cilën pretendon se gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme në vend ka vërejtur parregullsi të cilën e kanë evidentuar duke i bashkëngjitur si dëshmi fotografitë e printuara nga vendi i ngjarjes. Parashtruesi i ankesës potencon se me datën 04.06.2017, në Rrugën “Bahri Fazliu” (e njohur si rruga B), në Prishtinë, monitoruesi i tyre ka hasur në postera të kandidatëve për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, të ngjitur në objekt publike. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33, paragrafi 1, pika b, e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji Nr.03/L-073 dhe konsideron se Koalicioni PDK-AAK-NISMA, ka shkel këtë nen në momentin që ka vendosur poster të kandidatëve për deputet në hapësirë publike. Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkëngjitur dy fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja e kodit të mirësjelljes për subjektë politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë koalicioni PDK-AAK-NISMA, të datës 06.06.2017, ka pranuar shkeljen pretenduar në ankesë duke arsyetuar se nuk është e qëllimshme dhe se kjo është bërë nga aktivistë të pa informuar mirë me rregullat zgjedhore dhe se koalicioni PDK-AAK-NISMA pas marrjes së ankesës nga ana e PZAP-së, ka ndërmarrur masat përmirësuese, për evitimin e shkeljes sipas ankesës. Përgjigjies në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre kanë bashkëngjitur një foto nga vendi ku janë larguar posteret. PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posteret e kandidatit për deputet nga radhët e koalicionit PDK-AAK-NISMA, janë vendosur në objekt publik, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e koalicionit PDK-AAK-NISMA, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posteret e kandidateve për deputet nga koalicionit PDK-AAK-NISMA, janë vendosur në objekt publik të qytetit. Të cilën shkelje e ka pranuar edhe vetë koalicioni PDK-AAK-NISMA, në përgjigjen në ankesë të datës 06.06.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase koalicioni PDK-AAK-NISMA, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër të këtij fakti posteret e kandidatit për deputet nga ky koalicion PDK-AAK-NISMA, është vendosur në objekt publik. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që se koalicionit, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që i kanë tërhequr posteret në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 61/2017 më datën 06.06.2017.



**Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi**

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.